

## Vendim nr. 175 datë 25.07.2024

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahimimi, anëtarë, në datën 25.07.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 9 (S) 2024 të Regjistrisë Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** **STEPHAN MORGENSTERN**, përfaqësuar nga avokatët Arben Braçe dhe Ledi Bianku, me prokurë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 1875, datë 22.08.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; nr. 1631 (30-2023-5051), datë 20.09.2023 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; nr. 00-2023-2085, datë 12.12.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 17, 25, 27, pika 2, shkronja “dh”, 28, 116, 121, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, si dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 3, 5, pikat 1 dhe 4 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 228, pika 1, 229, 230, 236, 238, 245, 244, 249, 258-262, 493, 494 dhe 495 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*); ligji nr. 10193, datë 03.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale” (*ligji nr. 10193/2009*); Konventa Evropiane për Ekstradimin (*Konventa për Ekstradimin*); nenet 27, 43/b, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Genti Ibrahim, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## **V Ë R E N:**

### **I**

#### **Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesi Stephan Morgenstern, shtetas gjerman, është shpallur në kërkim ndërkombëtar mbi bazën e urdhrin të arrestit ndërkombëtar të lëshuar sipas vendimit nr. 2022-30930, datë 24.10.2022 të Gjykatës së Seoul-it në Korenë e Jugut, e cila ka caktuar ndaj tij masën e sigurimit “Arresti në burg” si i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Mashtrimi i rëndë” dhe “Shkelja e ligjit mbi rregulloren e kryerjes së biznesit për mbledhjen e fondeve”, të parashikuara nga Kodi Penal i Koresë së Jugut.

2. Në datën 18.08.2023 është bërë arrestimi i përkohshëm i kërkuesit nga oficeri i Policisë Gjyqësore i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, për qëllime të ekstradimit të tij për jashtë shtetit, konkretisht në Korenë e Jugut.

3. Me shkresën nr. 1508/1 prot., datë 18.08.2023, Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë Tiranë, ka paraqitur aktet për kryerjen e veprimeve procedurale për vleftësimin e masës së arrestit të përkohshëm dhe caktimin e masës së sigurimit për efekt të ekstradimit për jashtë shtetit të kërkuesit. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka kërkuar vleftësimin e arrestimit të kërkuesit dhe caktimin ndaj tij si masë sigurimi personal “Arresti në burg”, të parashikuar nga neni 238 i KPP-së, për efekt të ekstradimit të tij.

4. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 1875, datë 22.08.2023, ka vleftësuar të ligjshëm arrestimin e kërkuesit për qëllim ekstradimi dhe ka caktuar ndaj tij masën e sigurimit “Arresti në burg”, të parashikuar nga neni 238 i KPP-së. Sipas gjykatës së shkallës së parë, kërkuesi është person i shpallur në kërkim ndërkombëtar, ndërsa ndaj tij Gjykata e Seoul-it në Korenë e Jugut ka caktuar masën e sigurimit “Arresti në burg” si i dyshuar për kryerjen e veprave penale me rrezikshmëri shoqërore të lartë, për të cilat Kodi Penal shqiptar (*KP*) në nenin 143/3 parashikon dënimin nga pesë gjer në dhjetë vjet burgim, ndërsa në nenin 143/a parashikon dënimin nga dhjetë gjer në njëzet vjet burgim. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim.

5. Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 1631 (30-2023-5051), datë 20.09.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se masa e sigurimit më e përshtatshme është “Arresti në burg”, për shkak se është proporcionale në raport me rrezikshmërinë e veprave penale për të cilat kërkohet ekstradimi i kërkuesit, si dhe garanton mundësinë e ekstradimit dhe dorëzimit të tij në shtetin kërkues. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023- 2085, datë 12.12.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit për shkak se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së.

7. Në datën 29.04.2024 kërkuesi, përmes përfaqësuesve së tij, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 10.05.2024. Kolegji i Gjykatës në datën 17.07.2024 ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se gjatë procesit gjyqësor procedurat për miratimin dhe vleftësimin e masës së arrestit ndaj tij janë në shkelje të nenit 5 të KEDNJ-së dhe nenit 28 të Kushtetutës, për shkak të arrestimit në kushtet e pamundësisë ligjore për të proceduar me ekstradimin. Sipas kërkuesit, këto shkelje konsistojnë, në mënyrë të përmbledhur, në cenimin e:

8.1. *Së drejtës për t’u informuar dhe ndihmuar nga një përkthyes në gjuhën që kupton dhe mbajtja në burg pa vendim të arsyetuar në kohë*, sipas nenit 28, pika 1, të Kushtetutës dhe nenit 5 të KEDNJ-së, pasi ndihma e përkthyesit atij i është ofruar në datën 22.08.2023, ndërkohë që është arrestuar në datën 18.08.2023. Vendimi i Kolegjit Penal nuk ka asnjë analizë, qoftë edhe të përmbledhur, në lidhje me këtë pretendim të kërkuesit. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë për vleftësimin e masës së arrestit është shpallur në datën 22.08.2023 dhe i është dhënë i arsyetuar në datën 15.09.2023, pra 24 ditë pas shpalljes, në kundërshtim me nenet 245 dhe 249 të KPP-së. Edhe interpretimi i gjykatës së apelit në lidhje me këtë pretendim është në vetvete absurd, ndërkohë që mosrespektimi i afatit të arsyetimit të vendimit që vendos/miratton një masë heqjeje lirie përbën shkelje të dispozitave që lidhen me garantimin e lirisë dhe sigurisë së personit dhe çon automatikisht në shkelje të nenit 5, pika 1, të KEDNJ-së.

Vendimi i arsyetuar i është komunikuar kërkuesit kur kishin kaluar 960 orë përtej 48 orëve që parashikon neni 248 i KPP-së.

8.2. Masa e arrestit për qëllim ekstradimi shkel nenin 5, pika 1, të KEDNJ-së dhe nenin 27 të Kushtetutës, pasi prokurori ka kërkuar dhe gjykata ka dhënë një masë më të rëndë se ajo e kërkuar në njoftimin e Interpolit, i cili ka kërkuar arrestimin, por jo domosdoshmërisht atë në burg. Në kërkesën e tij prokurori ka paraqitur si shkak vetëm rrezikun e largimit të kërkuesit, por nuk përmend asnjë prej kushteve ose kritereve të përgjithshme e të veçanta në caktimin e masave të sigurimit personal, sipas neneve 228-230 të KPP-së. Gjykata e shkallës së parë nuk ka arsyetuar se përse nuk ka marrë parasysh kërkesën e mbrojtjes për caktimin e masës së sigurimit të garancisë pasurore ose të arrestit në shtëpi, as për papërshtatshmërinë e masave të tjera të sigurimit dhe as se përse “Arrestit në burg” ishte e vetmja masë e përshtatshme. Në lidhje me këtë pretendim gjykata e apelit është përgjigjur në mënyrë të përgjithshme, ndërsa Kolegji Penal nuk e përmend dhe nuk i jep përgjigje këtij pretendimi. Gjykatat kanë prezumuar dyshimin e arsyeshem në ngarkim të kërkuesit duke u mbështetur në faktin se ndaj tij gjykata e Seoul-it në Korenë e Jugut ka caktuar masën e sigurimit “Arrest” dhe në zbatim të kësaj mase është nxjerrë urdhri i arrestit ndërkombëtar, por nuk kanë tentuar të analizojnë nëse ky dyshim vazhdon të ekzistojë. As Kolegji Penal nuk ka bërë analizë dhe ka interpretuar sikur termi “masë shtrënguese” sipas nenit 494 të KPP-së do të thotë automatikisht arrest në burg.

8.3. Masa e arrestit për qëllime ekstradimi shkel nenin 5, pika 1, shkronja “f”, të KEDNJ-së dhe nenin 27 të Kushtetutës, sepse nuk janë respektuar kriteret formale të kërkuara nga neni 12 i Konventës për Ekstradimin. Dokumenti mbi bazën e të cilit gjykata e apelit justifikon miratimin e kërkesës për arrest nuk plotëson kërkesat e nenit 489 të KPP-së. Po kështu, jo vetëm që nuk ka të dhëna që provojnë fajësinë e kërkuesit, por ka të dhëna dhe fakte të falsifikuara e të rreme. Autoriteteve shqiptare u lind detyrimi të verifikojnë se kërkuesi nuk ndiqet për arsye politike dhe se nuk do t’u nënshtrohet persekutimeve ose diskriminimit. Kërkuesi ka pretenduar se në dosjen gjyqësore nuk ka ekzistuar ose të paktën nuk i është bërë e njohur dhe e aksesueshme kërkesa origjinale e ekstradimit e ardhur në rrugë diplomatike nga autoritetet koreane. Sipas tij, dokumenti i ndodhur në dosjen gjyqësore është vetëm një printim i një *e-mail*-i të dërguar elektronikisht dhe nuk ka në fakt një urdhërarrest në format origjinal ku të përshkruhen edhe arsyet e lëshimit të tij. Po sipas kërkuesit, fakti i mungesës së

dokumentacionit është evidentuar nga përfaqësuesi i tij si një nga shkeljet procedurale që në momentin e paraqitjes së ankimit në gjykatën e apelit dhe se vetëm në seancën e datës 05.02.2024, ajo gjykatë, pas insistimeve të mbrojtjes, ka njoftuar për herë të parë se në dosjen gjyqësore ishte përfshirë edhe kërkesa për ekstradim e ardhur në rrugë diplomatike nga autoritetet koreano-jugore.

- 8.4. Ekstradimi shkel nenin 5, pika 1, shkronja “f”, të KEDNJ-së dhe nenin 27 të Kushtetutës, pasi kërkuesi kërkohet të ekstradohet drejt një vendi që nuk është pjesë e KEDNJ-së, ndaj ai nuk mund të gëzojë mbrojtjen që ofron kjo e fundit dhe as të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të tij në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*). Ekstradimi mund të sjellë trajtimin e kërkuesit në kundërshtim me nenin 3 të KEDNJ-së dhe në këtë drejtim gjykatat jo vetëm nuk kanë kryer një vlerësim *proprio motu*, por nuk mbajnë parasysh asnjë nga raportet dhe vendimet gjyqësore që japin të dhëna të vlefshme për rrezikun e keqtrajtimin në rast ekstradimi dhe as nuk analizojnë garancitë që duhet të japin autoritetet koreane në mënyrë që ekstradimi të mos jetë në kundërshtim me këto dispozita. Kërkuesi në paraburgim mbahet në kushte të papërshtatshme. Nuk respektohet parimi i specialitetit, pasi referuar provave të dosjes gjyqësore dhe në mungesë të garancive nga autoritetet koreane, nuk përjashtohet mundësia që kërkuesi të gjykohet edhe për vepra të tjera në rast ekstradimi. Në paragrafin 47 të vendimit gjykata e apelit i referohet shkurtimisht deklaratave të autoriteteve koreane, por pa analizuar nëse veprat e tjera si “Mashtrimi i rëndë” janë përjashtuar, edhe pse kishte për detyrë të thellohej në këtë pikë jo vetëm për shkak të shprehjes “etj.” në kërkesën e ekstradimit, por edhe për shkak të një sërë dokumentesh që tregojnë se kërkuesi akuzohet për mashtrim të rëndë në Republikën e Koresë së Jugut. Gjykata e apelit duhet të analizonte nëse ekziston mundësia e ricilësimit të akteve për të cilat akuzohet kërkuesi, të kërkonte garanci dhe të vlerësonte se si gjykatat dhe autoritetet koreane e zbatojnë parimin e specialitetit. Kërkesa për ekstradim duhet të ketë formulime të qarta dhe strikte, kritere që nuk plotësohen në rastin konkret. As Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk i ka dhënë përgjigje këtij pretendimi, madje ky Kolegj në paragrafët 18 dhe 22 të vendimit konstaton mundësinë e dënimit me burgim të përjetshëm të kërkuesit në rast ekstradimi, por nuk bën asnjë lloj analize në lidhje me faktin nëse cenohen neni 27 i Kushtetutës dhe neni 5, pika 1, shkronja “f”, i KEDNJ-së.

### III

#### Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

##### A. Për legjitimitimin e kërkuarit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës.

10. Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkuarisi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet e kundërshtuara, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimet nr. 5, datë 17.03.2022; nr. 14, datë 11.03.2022; nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Si përjashtim, Gjykata ka vlerësuar se vendimet që vendosin masën e sigurimit personal “Arresti në burg”, duke qenë se lidhen me heqjen e lirisë së individit, konsiderohen përfundimtare për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 75, datë 22.12.2015; nr. 40, datë 18.07.2012; nr. 28, datë 23.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në kuptim të sa më sipër, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se objekt i ankimit kushtetues janë vendimet gjyqësore të të tria shkallëve të gjykimit që kanë caktuar ndaj kërkuarit masën e sigurimit personal “Arresti në burg” për qëllime ekstradimi. Duke qenë se këto vendime

kanë sjellë privimin e lirisë së kërkuesit, ato konsiderohen përfundimtare, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

13. Për sa u përket pretendimeve të parashtruara në kërkesë, rezulton se është pretenduar, në këndvështrim të nenit 27 të Kushtetutës dhe nenit 5, pika 1, shkronja “f”, të KEDNJ-së, se në situatën që kërkohet të ekstradohet drejt një vendi që nuk është pjesë e KEDNJ-së, kërkuesi nuk mund të gëzojë mbrojtjen që ofron kjo e fundit dhe as të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të tij në GJEDNJ në situatën që ekstradimi mund të sjellë trajtimin e tij në kundërshtim me nenin 3 të KEDNJ-së. Sipas kërkuesit, gjykatat nuk kanë vlerësuar dhe analizuar të dhëna të vlefshme për rrezikun e keqtrajtimin në rast ekstradimi dhe as nuk kanë analizuar garancitë që duhet të japin autoritetet koreane në këtë drejtim. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se nuk respektohet parimi i specialitetit, pasi referuar provave të dosjes gjyqësore dhe në mungesë të garancive nga autoritetet koreane, nuk përjashtohet mundësia që kërkuesi të gjykohet edhe për vepra të tjera në rast ekstradimi. Sipas kërkuesit, gjykata e apelit duhet të analizonte nëse ekziston mundësia e ricilësimit të akteve për të cilat ai akuzohet, të kërkonte garanci dhe të vlerësonte se si gjykatat dhe autoritetet koreane e zbatojnë parimin e specialitetit. Sipas tij, as Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk i ka dhënë përgjigje këtij pretendimi, madje në paragrafët 18 dhe 22 të vendimit ai konstaton mundësinë e dënimit me burgim të përjetshëm të kërkuesit në rast ekstradimi, por nuk shprehet nëse cenohet neni 27 i Kushtetutës dhe neni 5, pika 1, shkronja “f”, i KEDNJ-së.

14. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar se në dosjen gjyqësore nuk ka ekzistuar ose të paktën nuk i është bërë e njohur dhe e aksesueshme kërkesa origjinale e ekstradimit e ardhur në rrugë diplomatike nga autoritetet koreane. Sipas tij, dokumenti i ndodhur në dosjen gjyqësore është vetëm një printim i një *e-mail*-i të dërguar elektronikisht dhe nuk ka në fakt një urdhërarrest në format origjinal ku të përshkruhen edhe arsyet e lëshimit të tij. Sipas kërkuesit, fakti i mungesës së dokumentacionit është evidentuar nga përfaqësuesi i tij si një nga shkeljet procedurale që në momentin e paraqitjes së ankimit në gjykatën e apelit dhe se vetëm në seancën e datës 05.02.2024, ajo gjykatë, pas insistimeve të mbrojtjes, ka njoftuar për herë të parë se në dosjen gjyqësore ishte përfshirë edhe kërkesa për ekstradim e ardhur në rrugë diplomatike nga autoritetet koreano-jugore.

15. Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se pretendimet e kërkuesit lidhen me kërkesën për ekstradim, pra me themelin e çështjes, ndërkohë që objekti i procesit gjyqësor të kundërshtuar në rastin konkret lidhet me zbatimin e përkohshëm të masave shtrënguese përpara se të vijë kërkesa për ekstradim. Edhe neni 12 i Konventës për Ekstradimin kërkon dokumentacionin që duhet të paraqitet në mbështetje të kërkesës për ekstradim, ndërsa në rastin në shqyrtim jemi përpara aplikimit të nenit 16 të saj, për arrestimin e përkohshëm. Për këto arsye, Mbledhja e Gjyqtarëve

vlerëson se këto pretendime nuk mund të merren në shqyrtim në këtë moment, për sa kohë që kërkuksi ka ende mjete juridike efektive në dispozicion. Këto pretendime janë të tilla që, në kuptim të parimit të subsidiaritetit, duhet të shqyrtohen dhe të marrin përgjigje të arsyetuar nga gjykatat e zakonshme gjatë shqyrtimit të kërkesës për ekstradim, përpara se të vihet në lëvizje gjykimi kushtetues për shqyrtimin e tyre.

16. Për sa u përket pretendimeve të tjera të parashtruara në ankimin kushtetues individual, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuksi i është drejtuar Gjykatës pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave të zakonshme, për rrjedhojë nuk ka mjete të tjera ankimi në dispozicion.

17. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar nga kërkuksi, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 12.12.2023 dhe i është njoftuar i arsyetuar kërkuksit nga Gjykata e Lartë në datën 31.01.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 29.04.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

18. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuksi si shkelje procedurale në vlerësimin dhe zbatimin e masës së arrestit që kanë sjellë cenim të neneve 27 dhe 28 të Kushtetutës dhe nenit 5 të KEDNJ-së ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për t’u informuar dhe ndihmuar nga një përkthyes në gjuhën që kupton, pasi është arrestuar në datën 18.08.2023, ndërkohë që vetëm në datën 22.08.2023 ai është ndihmuar nga një përkthyes. Po kështu, kërkuksi ka ngritur pretendime edhe për vonesën në arsyetimin e vendimit gjyqësor, shkak për të cilin, sipas tij, masa e sigurimit ka humbur efektet e saj.

19. Për sa i përket pretendimit të parë të kërkuksit, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se sipas nenit 28, pika 1, të Kushtetutës, kushdo, të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet. Personit të cilit i është hequr liria, duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin, si dhe t’i jepet mundësia për realizimin e të drejtave të tij. E drejta për të pasur ndihmën e një përkthyesi, kur nuk e flet ose nuk e kupton gjuhën shqipe, e cila është sanksionuar në mënyrë të shprehur si një e drejtë e të akuzuarit në procesin penal (neni 31, shkronja “a”, i Kushtetutës) është në funksion të së drejtës së mbrojtjes (*shih vendimin nr.35, datë 25.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se norma kushtetuese shprehet për njoftimin e personit që i hiqet liria “në një gjuhë që ai kupton”, pra jo domosdoshmërisht në gjuhën e vendit, shtetësinë e të cilit ka ai person, për sa kohë që qëllimi i saj është të sigurojë



njoftimin e personit të ndaluar ose të arrestuar në atë masë që është e mjaftueshme për t'i lejuar të kuptojë arsyet për heqjen e lirisë.

20. Sipas GJEDNJ-së, ndihma e një përkthyesi, si ajo e një avokati, duhet të ofrohet që në fazën e hetimit, përveç rasteve kur tregohet se ka arsye bindëse për të kufizuar këtë të drejtë (*shih Diallo kundër Suedisë, datë 5 janar 2010, § 25*). Në përcaktimin e nevojave për përkthim, çështja e njohurive gjuhësore është jetike. Kur i pandehuri zotëron gjuhën e procesit ose, siç mund të jetë rasti, një gjuhë të tretë në të cilën përkthimi është lehtësisht i disponueshëm, në vetvete nuk duhet të pengojë individin të përfitojë nga përkthimi në një gjuhë që ai ose ajo e kupton mjaft mirë për të ushtruar plotësisht të drejtën e mbrojtjes. Kjo rrjedh nga kërkesa që i pandehuri të informohet për akuzën në një gjuhë “*të cilën ai e kupton*” dhe nga kërkesa që ndihma e përkthimit të jetë e tillë që t'i mundësojë të pandehurit të ketë njohuri për çështjen kundër tij dhe që ai të mbrohet (*shih Hermi kundër Italisë [GC], nr. 18114/02, datë 18 tetor 2006*).

21. Në kuptim të këtyre standardeve, ligji procedural penal përcakton përkthyesin si një nga pjesëmarrësit e procedimit penal me qëllim që përmes komunikimit me të pandehurin (ose personin e barazuar me të në një proces penal) në gjuhën e tij amtare ose atë që kupton, nëse ai nuk flet dhe nuk e kupton gjuhën shqipe të procesit, ky i fundit të realizojë të drejtat e tij në procesin penal, ndër to dhe kur është rasti, edhe asaj për t'u njohur me shkaqet e arrestimit dhe për akuzën që i bëhet.

22. Mbledhja e Gjyqtarëve, referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij shqyrtimi, konstaton se sipas procesverbalit për arrestimin e përkohshëm të datës 18.08.2023, të mbajtur nga oficeri i Policisë Gjyqësore, arrestimi i kërkuesit është bërë në prani të shtetasit shqiptar R.H, i deklaruar si person i besuar i tij, ndërsa ky i fundit ka pohuar se zotëronte shumë mirë gjuhën shqipe dhe atë angleze, kurse këtë të fundit e zotëronte shumë mirë edhe kërkuesi. Po kështu, në procesverbal evidentohet se arrestimi i kërkuesit bëhej për shkak se ishte në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Koreja e Jugut prej datës 25.10.2022, ndërsa Gjykata e Seoul/Koreja e Jugut, me vendimin nr. 2022-30930, datë 24.10.2022, ka caktuar ndaj tij masën e sigurimit “Arresti në burg” si i dyshuar për veprat penale “Mashtrimi i rëndë” dhe “Shkelja e ligjit mbi rregulloren e kryerjes së biznesit për mbledhjen e fondeve”, të parashikuara nga Kodi Penal i Koresë së Jugut. Po sipas procesverbalit, pasi është njohur me të drejtat e të arrestuarit, kërkuesi ka zgjedhur si mbrojtës shtetasin K.K., anëtar i dhomës së avokatisë të Tiranës, ndërsa ky i fundit është njoftuar menjëherë dhe ka qenë i pranishëm në veprimet ligjore në vijim. Procesverbali i arrestimit të përkohshëm është nënshkruar rregullisht dhe pa vërejtje nga kërkuesi dhe shtetasi R.H.

23. Po kështu, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se seanca e parë gjyqësore e datës 21.08.2023, e planifikuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë për shqyrtimin e kërkesës së prokurorit për vleftësimin e arrestimit të përkohshëm dhe caktimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit, nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së një përkthyesi në gjuhën amtare (gjermane) të kërkuesit ose të gjuhës angleze që ai ka deklaruar se e kuptonte. Në seancën e radhës, atë të datës 22.08.2023, e pranishme ka qenë një përkthyes zyrta e gjuhës angleze, ndërsa kërkuesi ka lëshuar një deklaratë me shkrim sipas së cilës ai nuk e fliste gjuhën shqipe dhe kishte nevojë për përkthyes të gjuhës angleze. Në vijim, kërkuesi është asistuar nga përkthyesja e gjuhës angleze, e cila e ka asistuar atë edhe gjatë procesit gjyqësor në gjykatën e apelit. Përgjatë procesit gjyqësor në dy shkallët e para të gjykimit kërkuesi nuk ka ngritur ndonjë pretendim në lidhje me cenimin atij të së drejtës për t'u informuar dhe ndihmuar nga një përkthyes në gjuhën që kupton. Këtë pretendim ai e ka ngritur vetëm në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë dhe, në vijim, në ankimin kushtetues individual, duke e lidhur atë me mungesën e pranisë së një përkthyesi në momentin e arrestimit dhe njohjes, përmes përkthyesit, për shkaqet e kësaj mase dhe për akuzën që i bëhej.

24. Për sa më sipër, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se në procesin penal kërkuesit i është garantuar e drejta për t'u informuar dhe ndihmuar nga një përkthyes në një gjuhë që ai kuptonte, konkretisht në gjuhën angleze. Për sa i përket momentit të arrestimit të kërkuesit, është e vërtetë se nuk ka qenë i pranishëm ndonjë përkthyes zyrtar i gjuhës së tij amtare (gjermane) ose i gjuhës angleze që ai kuptonte. Megjithatë, neni 28, pika 1, i Kushtetutës garanton të drejtën e individit të cilit i hiqet liria, për t'u njoftuar menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet. Në fakt, pavarësisht mungesës së një përkthyesi zyrtar në momentin e arrestimit, rezulton dhe nuk kundërshtohet se kërkuesi është njoftuar menjëherë në gjuhën angleze për shkaqet e arrestimit dhe akuzën që i bëhej. Ky njoftim është bërë me ndihmën e një shtetasi shqiptar të pranishëm në atë moment, i cili shfaqet si person i njohur dhe i besuar i kërkuesit, ndërsa ka pranuar se është njohës i kësaj gjuhe dhe ka marrë përsipër dhe transmetuar kërkuesit njoftimet e bëra për të nga oficeri i Policisë Gjyqësore. Po kështu, është fakt se jo shumë kohë pas arrestimit të kërkuesit, është paraqitur mbrojtësi i zgjedhur prej tij, i cili ka qenë i pranishëm në veprimet ligjore të realizuara në vijim në lidhje me arrestimin e përkohshëm të kërkuesit për qëllime ekstradimi. Në këtë kuptim, vetëm fakti se njoftimi i shkaqeve të arrestimit dhe i akuzës që i bëhej nuk është bërë me ndihmën e një përkthyesi zyrtar, nuk mund të çojë në mohimin e faktit se ai ka marrë një njoftim të tillë, për më tepër kur nuk kontestohet saktësia e njoftimit të bërë në këtë drejtim sipas procesverbalit të arrestimit. Ndërkohë, për sa i përket procesit gjyqësor

përpara gjykatave të faktit, sikundër nuk kontestohet, kërkuesi është ndihmuar rregullisht nga një përkthyes zyrtar i caktuar në përputhje me parashikimet e ligjit procedural penal. Për pasojë, ky pretendim është haptazi i pabazuar.

25. Për sa më sipër, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se, edhe pse referuar vendimit të Kolegjit Penal nuk rezulton që kërkuesi të ketë marrë përgjigje për këtë pretendim të ngritur në rekurs, pra se nga momenti i arrestimit dhe deri në zhvillimin e seancës së parë atij nuk i është komunikuar në gjuhën që kuptonte arsyeja e arrestimit, arsyetimi i kufizuar i vendimeve të Gjykatës së Lartë që kanë vendosur mospranimin e rekursit nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mosprimit të rekursit nga ana e kolegjeve të asaj gjykate gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit.

26. Për sa i përket pretendimit tjetër të kërkuesit, se masa e sigurimit ka humbur efektet e saj për shkak të mosarsyetimit të vendimit nga gjykata e shkallës së parë brenda 48 orëve, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se sipas nenit 495, pika 3, të KPP-së gjykata brenda 48 orëve nga paraqitja e kërkesës e vleftëson atë, si dhe cakton një masë sigurimi shtrënguese, kur janë kushtet, ose vendos lirim të arrestuarit. Në rastin konkret, referuar akteve të dosjes gjyqësore, rezulton që vendimi i gjykatës së shkallës së parë të jetë dhënë brenda afatit prej 48 orësh. Ndërkohë që për sa i përket kohëzgjatjes së arsyetimit të vendimit, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkuesi nuk ka arritur të provojë pasojat e ardhura për këtë shkak, për sa kohë që ai nuk është penguar në të drejtën e tij kushtetuese për të paraqitur ankim në një gjykatë më të lartë, të drejtë që ai e ka ushtruar duke paraqitur ankim në gjykatën e apelit në datën 13.09.2023, i cili është marrë në shqyrtim nga ajo gjykatë, duke i dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të parashtruara prej tij. Për më tepër, rezulton që ky pretendim të jetë marrë në shqyrtim edhe nga gjykata e apelit edhe Gjykata e Lartë, të cilat i kanë dhënë përgjigje në drejtim të bazueshmërisë së tij, duke arsyetuar, në interpretim të dispozitave të KPP-së, se ligjvënësi e ka lidhur pasojën e humbjes së fuqisë vetëm me rastin kur nuk është respektuar afati i shqyrtimit të çështjes dhe jo me rastin kur nuk është respektuar afati i arsyetimit të vendimit.

27. Për sa më sipër, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se në rastin e kërkuesit rezulton që autoritetet ligjzbatuese dhe gjykatat të kenë vepruar në përputhje me parashikimet kushtetuese dhe ligjore, ndaj pretendimet e tij në drejtim këtyre procedurave janë haptazi të pabazuara.

28. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se prokurori ka kërkuar dhe gjykata ka dhënë një masë më të rëndë se ajo e kërkuar në njoftimin e Interpolit, sipas të cilit është kërkuar arresti, por jo domosdoshmërisht ai me burg. Sipas kërkuesit, caktimi i arrestit në burg, duke iu referuar vetëm rrezikut të ikjes ose rrezikshmërisë shoqërore të veprës, bie në kundërshtim me standardet

ndërkombëtare, ndërkohë që gjykatat nuk kanë arsyetuar se përse nuk është marrë parasysh kërkesa e mbrojtjes për caktimin e masës së sigurimit të garancisë pasurore ose të arrestit në shtëpi dhe as për papërshtatshmërinë e masave të tjera alternative të parashikuara nga nenet 233, 234 dhe 235 të KPP-së.

29. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesi është arrestuar për qëllime ekstradimi nga Policia e Shtetit. Në vijim, me kërkesën e datës 18.08.2023, prokurori i është drejtuar gjykatës me kërkesë për vleftësimin e arrestimit të përkohshëm të kërkuesit dhe caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, të parashikuar nga neni 238 i KPP-së, për efekt ekstradimi të këtij shtetasi në Korenë e Jugut. Kërkesa e prokurorit bazohet në kërkesën e autoriteteve të atij shteti, të cilat kanë caktuar ndaj kërkuesit të njëjtën masë sigurimi si i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Mashttrim i rëndë” dhe “Shkelja e ligjit mbi rregulloren e kryerjes së biznesit për mbledhjen e fondeve”, të cilat në shtetin kërkues konsiderohen vepra penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore duke parashikuar dënim maksimal deri në burgim të përjetshëm.

30. Gjykata e shkallës së parë ka pranuar kërkesën, duke caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit personal “Arresti në burg”, të parashikuar nga neni 238 i KPP-së, pasi ka vlerësuar se, në vështrim të nenit 253 të KPP-së, arrestimi i përkohshëm për qëllime ekstradimi i kërkuesit është plotësisht i ligjshëm dhe masa e kërkuar nga prokurori është në përshtatje me nevojat e sigurimit, rrezikshmërinë e faktit dhe të personit në fjalë (*shih faqet 3-5 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*).

31. Gjykata e apelit, e vënë në lëvizje mbi bazën e ankimit të kërkuesit, ka miratuar masën e caktuar nga gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar se, në rastin konkret, caktimi i masës së sigurimit kushtëzohet nga ekzistenca e kushteve të parashikuara në nenin 494 të KPP-së dhe ekzistenca e një vendimi të huaj për caktimin e një mase për kufizimin e lirisë personale elemente këto të mjaftueshme për të proceduar me caktimin e përkohshëm të një mase shtrënguese, me qëllim garantimin e ekstradimit të personit në shtetin kërkues, të cilit i takon dhe vendimmarrja për procedimin penal. Sipas asaj gjykate, në lidhje me pretendimin për caktimin e masës së sigurimit “Garanci pasurore”, rrezikshmëria shoqërore e veprave penale dhe e vetë autorit e bën të papërshtatshme vendosjen e saj (*shih paragrafët 46, 54 dhe 56 të vendimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë*). Edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbi bazën e pretendimeve të parashtruara në rekurs, ka arsyetuar se gjykata e apelit ka marrë në analizë dhe arsyetuar mbi pretendimet e shtetasit të arrestuar për pavlefshmërinë e vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Gjithashtu, gjykata e apelit ka marrë në shqyrtim proporcionalitetin e masës së

sigurimit dhe arsyet se përse masa e sigurimit e kërkuar, ajo e “garancisë pasurore”, nuk mund të aplikohet në rastin konkret (*shih paragrafin 20 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

32. Për sa u përket pretendimeve të kërkuesit në lidhje me përshtatshmërinë e masës së sigurimit, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se masa e sigurimit “Arresti në burg” është caktuar ndaj tij nga autoritetet koreane si i dyshuar për kryerjen e disa veprave penale. Në vijim, arrestimi i përkohshëm i kërkuesit nga autoritetet shqiptare dhe caktimi i masës së sigurimit të kundërshtuar është vendosur për qëllime të ekstradimit të tij. Në vendimet objekt kërkese, gjykatat, në përputhje me nenet 229 dhe 230 të KPP-së, kanë dhënë arsyet ligjore mbi bazën e të cilave kanë caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit “Arresti në burg”, si dhe arsyet se përse një masë e ndryshme nuk është e përshtatshme në rastin konkret. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

33. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.<sup>1</sup>

### **PËR KËTO ARSYE,**

Mbledhja e Gjyqtarëve, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

---

<sup>1</sup> Gjyqtaret Fiona Papajorgji dhe Marjana Semini votuan për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, pasi, pretendimet e kërkuesit, nuk janë haptazi të pabazuara, e si të tilla nuk mund të bëhen objekt i shqyrtimit paraprak.